

përkatësisht pranë Teatrit Kombëtar të Kosovës, ku janë zbuluar dy objekte, një çezme dhe një bazament (themele) të një objekti të arkitekturës.

Çezma ka trajtë drejtkëndëshi. Është e orientuar verilindje – jugperëndim. Ishte e murosur me gurë të lidhur me llaç gëlqereje të bardhë. Në pjesën jugperëndimore ngrihej govata si pjese përbërëse e Çezmës. Çezma ka formë katërkëndësh me dimensione: lartësi 0.76 m, gjerësi 0.80 m dhe gjatësi 1.33 m. Govata ka forme te gjysme rrethit me këto dimensione: 1.10 m x 0.50 m. Në anën juglindore dhe veriperëndimore ka qenë e veshur me pllaka mermeri. Govata është ngritur me pllaka gurësh të varreve të ripërdorura (spolie), disa prej të cilave ruajnë mbishkrime epitafesh të shkruara në alfabetin osman/arab, sikurse edhe zbukurime me motive bimore etj. Sipas pllakës së përforcuar të govatës në anën e poshtme, me llaç çimentoje mund të gjykojmë që Çezma është ngritur apo riparuar në gjysmën e parë të shekullit XX dhe paraqet njërin nga dhjetëra krojet publike të qytetit të Prishtinës. Po ashtu vlen të veçohet që pranë Çezmës u gjeten edhe copa gurësh plastik mermeri (pjesë varresh) të zvarritur e të dëmtuar gjatë viteve 50 – ta të shekullit XX.

Themelet, përkatësisht bazamenti i një objekti të arkitekturës u zbulua rreth 20m në jugperëndim të Çezmës, të cilat ngriheshin nga blloqe gurësh gëlqerorë, rrasave të gurëve etj. Baza e këtij bazamenti ka këto dimensione: 2.80 x 2.80 m me lartësi 1m. Bazamenti i ka takuar një objekti të arkitekturës qytetare të Prishtinës. Në fazën e gjurmimeve të tashme është vështirë të datohet me saktësi. Datimin e tij e vështirëson gjymtimi i objektit sikurse edhe shkatërrimi i shtresave kulturore gjatë ndërtimeve të viteve 50 – ta të shekullit XX.

Rekomandojmë Komisionin për Trashëgimi Kulturore të MKRS-së që këto dy objekte të trajtohen sipas kriterëve të mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore.

Me respekt,

Dr.sc. Enver Rexha


DREJTOR-IAK

Haxhi Mehmetaj, Arkeolog


DREJTOR - IMMRP